



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Kontabiliteti Financiar
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Mars 2018

Kontabiliteti Financiar

- Viti II-të, Semestri IV
- Departamenti : KF
- Statusi i lëndes : Obligative
- Javët mësimore: 15 [4 orë ligjerata, 8 orë ushtrime(4 grupe)]
- Mësimdhënëse: Prof.Ass.Dr. Fitim Deari
- Asistent: MSc.Valdrin Misiri
- Orari i ushtrimeve: E hene (G4 – ora 09:45 - 11:15 E4)
- (G3 – ora 13:15 - 14:45 CI)
- (G2 – ora 15:00 - 16:30 CI)
- Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 11:30 - 13:00 CI)
- E-mail: valdrin.misiri@unhz.eu
- Website: www.unhz.weebly.com

Pasuria Afatgjatë (joqarkulluese)

- Llojet e pasurisë (aseteve) afatgjatë
- Percaktimi i kostos fillestare të patundshmerive, impianteve dhe pajisjeve
- Toka
- Permirësimet në tokë
- Blerjet në grup të pasurive materiale
- Ndërtesat, Makineritë dhe Pajisjet
- Shpenzimet kapitale
- Zhvlerësimi i patundshmerive, impianteve dhe pajisjeve
- Matja e zhvlerësimit të pasurisë materiale
- Metodatat e zhvlerësimit

Llojet e pasurisë(aseteve) afatgjatë

- Pasuria afatgjatë konsiston në pasurinë kryesore prodhuese për shumicën e ndërmarrjeve. Kjo pasuri është esenciale për ardhmërinë e ndërmarrjes në periudha afatgjata.
- Dy llojet kryesore të pasurisë afatgjatë janë:
 1. Pasuria afatgjatë materiale
 2. Pasuria afatgjatë jomateriale ose e paprekshme

Llojet e pasurisë(aseteve) afatgjatë

- Pasuria afatgjatë materiale:
 1. Patundshmeritë
 2. Impiantet
 3. Pajisjet
- Pasuria afatgjatë jo materiale(paprekshme):
 1. Patentat
 2. Licencat
 3. Goodëilli
 4. Shenja tregtare
 5. Investimet në bashkëpronësi
 6. Franshiza
 7. Investimet financiare

Llojet e pasurisë(aseteve) afatgjatë

- Elementet kryesore të pasurisë afatgjatë materiale janë:
 1. Toka
 2. Permirësimet në tokë
 3. Ndërtesat
 4. Makineritë
 5. Mobiljet dhe pajimet e palëvizshme
 6. Resurset natyrore
- Toka ndryshe nga elementet e tjera të pasurisë nuk zhvlerësohet, sepse ajo nuk ka afat të kufizuar të përdorimit
- Po ashtu resurset natyrore nuk zhvlerësohen, por të njëjtat duke u nxjerrë nga toka transformohen në rezerva dhe hargjohen apo shërren në mënyrë kontinuele

Percaktimi i koston fillestare të patundshmërive, impianteve dhe pajisjeve

- Pasuria afatgjatë, e klasifikuar si patundshmeri, impiante dhe pajisje fillimisht regjistrohet me koston e blerjes duke respektuar në këtë rast parimin e koston historike.
- Ne koston e blerjes se ketyre pasurive, perfshihen të gjitha shpenzimet e nevojshme të cilat mundësojnë që pasuria e blerë të jetë e gatshme për përdorim.

Percaktimi i koston fillestare të patundshmërive, impianteve dhe pajisjeve

- Elementet të cilat përfshihen ne koston e blerjes
 1. Cmimi i blerjes
 2. Tatimet e paguara në kohën e blerjes
 3. Shpenzimet e transportit
 4. Kosto e instalimit
 5. Kosto të tjera të cilat i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së pasurisë
- Shembuj të kostove të panevojshme, të cilat përfshihen ne koston fillestare janë:
 1. Kostot e dëmtimit të pasurisë gjatë instalimit
 2. Vjedhjet e pasurisë së pasiguruar
 3. Shkatërrimet vandale të pasurisë
 4. Gjobat për mosplotësimin e kushteve të pasurisë, të parapara sipas agjensioneve qeveritare etj;

Toka

- Kostoja e blerjes së tokës përfshin cmimin e blerjes plus shpenzimet përcjellëse, që lidhen me blerjen e tokës sic janë:
 - Provizionet e ndërmjetësuesve të patundshmerive,
 - Kompenzime ligjore për vërtetësinë dhe sigurimin e pronësisë,
 - Kompenzimet për taksat e shitjes së patundshmërive,
 - Shpenzimet për matje,
 - Kompenzime për pastrimin e pronës etj.
- Për tokën në kontabilitet mbahet llogari e vecantë sepse ajo nuk është subjekt i zhvlerësimit ose harxhimit.

Shembull

- Firma “ Devolli Corp.” me 16.07.2016 ka blerë tokë ne vlerë prej 250.000 € me afat pagese 45 ditë.
- “Devolli Corp.” ka paguar 5.500 € në kesh në emer të tatimit në pronë, 1.000 në emer të taksave të shitjes së pronës, 1.200 € per matjen e tokës dhe 500 € për vendosjen e shenjave të tokës. Beni regjistrimin kontabel ne rastin e blerjes së tokës.

Përmirësimet në tokë

- Për tokën dhe përmirësimet në tokë në kontabilitet, mbahen llogari të vecanta sepse përmirësimet në tokë janë subjekt i zhvlerësimit.
- Përmirësimet në tokë janë:
 1. Rrugët,
 2. Sistemet e ujitjes,
 3. Instalimet ndricuese,
 4. Rrethojat,
 5. Shenjat e tokës etj.
- Në koston e përmirësimeve në tokë përfshihen të gjitha shpenzimet e nevojshme, që mundësojnë krijimin e tokës në gjendje të rregullt për përdorim.

Shembull

- Supozojmë se “Devolli Corp.” në tokën e blerë më parë më datën 16.07.2007 ka investuar sistemin e ujitjes për 20.000 €, për instalimet ndricuese në token e blerë ka paguar 3.400 € dhe shtrimin e rruges me zhavor pastaj me asfalt 5.800 €. Të gjitha këto investime janë paguar në kesh.
- Kostoja totale e përmirësimeve në tokë, lidhur me shembullin, është 29.200 €.

Blerjet në grup të pasurive materiale

- Firmat në të shumten e rasteve i blejnë së bashku tokën dhe ndërtesat. Nga prizmi i kontabilitetit është e rëndësishme të ndahet kostoja fillestare e blerjes ndermejt tokes dhe ndërtesave.
- Sic dihet toka nuk është pasuri e zhvlerësushme, ndërsa shumë e ndarë për ndërtesat është subjekt i zhvlerësimit.
- Kostoja e blerjes në grup e pasurive shpërndahet ndërmejt kategorive të grupit në bazë të vlerave relative të tregut për pasuritë e ndryshme të blera

Shembull

- Supozojmë se me 25.03.2016 “Devolli Corp.” ka blerë një ndërtesë në Prishtinë se bashku me tokën në të cilën gjendet ndërtesa, në vlerë prej 200.000 € në kesh.
- Menaxhmenti i “Devolli Corp.” dhe ekspertet e shitjes së patundshmërive kanë vlerësuar se sikur të bliheshin ndaras, atëherë sipas vlerës së tregut do të kushtonin: toka 170.000 €, kurse ndërtesa 70.000 €. “Devolli Corp.” mbi bazën e vlerës së tregut të vlerësuar bënë ndarjen e pasurive të cilat ishin blerë në grup.

Ndërtesat

- Deri në zotërim të ndërtesave, të cilat i përdorin në aktivitetet e tyre operative, firmat vijnë në tri menyra:
 1. *Blerja e ndërtesave të gatshme.*
 2. *Konstruktimi i ndërtesave nga vet firma.*
 3. *Konstruktimi i ndërtesave nëpërmjet kontraktimit të firmave ndërtimit.*
- Kur blihen ndërtesat e gatshme në koston fillestare përfshihen cmimi i blerjes, shpenzimet e përmirësimeve (riparimit, renovimit etj.) si dhe të gjitha shpenzimet tjera që janë të nevojshme për ta bërë ndërtesën të gatshme për përdorim.

Ndërtesat

- Në qoftë se konstruktimi i ndërtesës bëhet prej aktivitetit të vetë firmes në koston fillestare të ndërtesës, përfshihen: kostoja e ndërtimit si dhe të gjitha shpenzimet e tjera të nevojshme sic janë puna direkte, materiali direkt, kompenzimet per arkitekt, shpenzimet e lejes së ndertimit, kompenzimit për avokatë si dhe shpenzimet tjera indirekte operative.
- Kur ndërtesa konstruktohet nëpërmjet firmave ndërtimore të kontraktuara, atëherë koston fillestare të ndërtesës e përbën vlera neto e kontraktuar me firmën ndërtimore dhe gjitha shpenzimet tjera qe lidhen me të.

Makineritë dhe pajisjet

- Në koston e makinerive dhe pajisjeve përfshihen të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme të ndodhura lidhur me blerjen e tyre dhe përgatitjen e tyre në gjendje të gatshme për përdorim.
- Në koston fillestare të makinerive dhe pajisjeve përfshihen:
 1. *Cmimi i blerjes (i pakuar për zbritje),*
 2. *Shpenzimet e transportit,*
 3. *Shpenzimet e sigurimit tranzit,*
 4. *Shpenzimet e doganës dhe TVSH-të,*
 5. *Shpenzimet e instalimit,*
 6. *Shpenzimet e testimit përpara përdorimit,*
 7. *Komisionet (provizionet e blerjes) etj.*

Shembull

- Supozojmë se firma “Devolli Corp.” ka blerë makineri në vlerë prej 70.000 € me afat pagese 3 muaj. Për shpenzimet e transportit janë paguar 2.800 € në kesh, gjithashtu janë paguar në kesh 850 € për shpenzime të instalimit dhe 400 € për shpenzimet e testimit të makinerive. Makineritë janë vënë në përdorim me 01.08.2016.

Shpenzimet kapitale

- Shpenzimet e bëra, për blerjen dhe zgjerimin e pasurisë materiale emërtohen si shpenzime kapitale dhe të njëjtat evidencohen ne llogarinë e pasurisë.
- Përvec shpenzimeve, të lidhura me blerjen dhe zgjerimin e pasurisë materiale, në shpenzime kapitale, përfshihen edhe ato të cilat e zgjasin afatin e përdorimit ose e rrisin vlerën e pasurisë afatgjatë ekzistuese.
- Sipas FABS shpenzime kapitale konsiderohen edhe kamatat e kreditit (IAS 23) gjatë periudhës ndërtimore ose prodhimit të pasurisë afatgjate ndersa sipas SNK 12 ato konsiderohen si shpenzime operative (afariste).

Shpenzimet kapitale

- Shpenzimet e bëra për mirëmbajtjen ose riparimet, të cilat nuk e zgjasin afatin e përdorimit ose e rrisin vlerën e pasurisë materiale ekzistuese, njihen si shpenzime operative, dhe si të tilla regjistrohen në llogarinë e shpenzimeve.
- Shpenzimet operative janë të dobishme për pasurinë afatgjatë vetëm në periudhën aktuale dhe kryesisht ato nuk janë në shuma të mëdha.
- Alokimi i drejtë, ndërmjet shpenzimeve kapitale dhe operative, është me rëndësi të vecantë sepse ato ndërlidhen me përcaktimin e fitimit neto të çdo periudhe.

Shembull

- Supozojmë se më 30.08.2016 firma “Devolli Corp.” ka bërë riparime në depon e mallrave të shumicës në Pejë. Për shpenzimet vendosjes së tjegullave të reja dhe rregullimeve mbi çatinë e deposë janë paguar 17.200 € në kesh, ndërsa për ngjyrosjen e deposë janë paguar 800 €. “Devolli Corp.” bën regjistrimin kontabël si në vijim:

Zhvlerësimi i patundshmërive, impianteve dhe pajisjeve

- Procesi i shpërndarjes (alokimit) së kostos fillestare të pasurisë materiale në shpenzime të periudhës gjatë gjithë afatit të përdorimit të tyre emërtohet zhvlerësim.
- Njohja e shpenzimeve të zhvlerësimit bëhet në të gjitha vitet e jetëgjatësisë së pasurisë materiale.
- Përvec tokës, pasuritë afatgjatë afatin e përdorimit të tyre e kanë të kufizuar.
- Për shumicën e impianteve dhe pajisjeve arsyet kryesore të zhvlerësimit janë:
 1. Vjetërsimi dhe
 2. Dëmtimi fizik i tyre

Zhvlerësimi i patundshmërive, impianteve dhe pajisjeve

- Termi zhvlerësim, i përdorur në kontabilitet, nuk nënkupton dëmtimin fizik të pasurisë materiale ose zvogëlimin e vlerës së tregut të tyre.
- Matja e zhvleresimit vjetor bazohet në koston fillestare të pasurisë dhe jo në vlerën aktuale të tregut.
- Pra zhvlerësimi është proces i shpërndarjes së koston fillestare e cila është matur më parë me parimin e koston historike.
- Zhvleresimi i akumuluar paraqet koston e pasurisë, e cila është shpërndarë në shpenzimet e periudhave, dhe ndryshe njihet se kontra pasuri në bilancin e gjendjes

Zhvlerësimi i patundshmërive, impianteve dhe pajisjeve

Zhvlerësohen

- Ndërtesat,
- Impiantet,
- Pajisjet.

Amortizohen

- Patenta,
- Licencat,
- Goodwill,
- Shenjat Tregtare.

Shterren (Harxhohen)

- Resurset natyrore
- Pyjet,
- Nafta,
- Mineralet etj.

Matja e zhvlerësimit të pasurisë materiale

- Në llogaritjen e shumës së shpenzimeve të zhvlerësimit bazohet në tre faktorë:
 1. Kosto fillestare.
 2. Jetëgjatësia (afati i përdorimit) e vlerësuar.
 3. Vlera riziduale e vlerësuar.

Metodat e zhvlerësimit

- Zhvlerësimi i pasurisë, më së shumti llogaritet nëpërmjet metodave si në vijim:
 1. Metodës lineare (vijes së drejtë)
 2. Metodës së njësive të prodhimit (funksionale)
 3. Metodës së zhvlerësimit të shpejtuar.
- Zhvlerësimin e pasurisë gjatë periudhave secila nga këto metoda e llogarisin në shuma të ndryshme, por në total rezultati i zhvlerësimit të pasurisë është në shuma të njejta në të gjitha metodat.

Metoda lineare

- Brenda metodës lineare, zhvlerësimi i kostos së pasurisë shpërndaheq ne shuma të barabarta për secilen periudhë gjatë gjithë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë
- Diferenca ndërmjet kostos fillestare të pasurisë dhe vlerës riziduale quhet kosto e zhvlerësueshme.
- Në metoden lineare, shuma e zhvlerësimit vjetor përcaktohet në bazë të kesaj formule:

$$\text{Shpenzimet e zhvlerësimit} = \frac{\text{Kosto fillestare} - \text{vl. riziduale}}{\text{Jetëgjatësia e vlerësuar}}$$

Shembull

- Firma “Elkos” me 01 janar të vitit 2010 ka blerë makineri për 52.000 €. Jetëgjatësia e vlerësuar është 5 vite, kurse vlera riziduale (mbetur) është 2.000 €.
- Prcaktoni shpenzimet e zhvlerësimit vjetor, zhvlerësimin e akumuluar dhe vleren kontabel të makinerive për të gjitha vitet e jetëgjatësisë nëpërmjet metodes lineare dhe beni veprimet rregulluese të datës 31.12.2012.

Metoda e zhvlerësimit të shpejtuar

- Termi zhvlerësim i përshpejuar i referohet përdorimit të atyre metodave të zhvlerësimit, sipas të cilave llogariten dhe njihen shuma të larta të zhvlerësimit, në vitet e para të përdorimit të pasurisë, në krahasim me vitet e ardhshme, në të cilat shumat e zhvlerësimit janë më të ulëta.
- Metoda e zhvlerësimit të shpejtuar shpeshherë në praktikë është përdorur për qëllime tatimore sepse duke llogaritur shuma të larta të zhvlerësimit.

Metoda e zhvlerësimit të shpejtuar

- Dy format kryesore të zhvlerësimit të shpejtuar janë:
 1. Metoda e saldos zvogëluese (rënëse)
 2. Metoda e shumës së numrave të viteve të jatëgjatësisë.
- **Metoda e saldos zvogeluse** ndryshe emërtohet metodë e saldos zvogëluse të dyfishtë.
- Norma e zhvlerësimit të shpejtuar është e njëjtë për të gjitha vitet. Ajo llogaritet si rezultat i normës lineare të shumëzuar me 2

Shembull

- Supozojmë se “Enex Trade” në Pejë më 01.01.2012 ka vënë makineri të reja në përdorim me kosto fillestare prej 50.000, kurse afati i përdorimit është vlerësuar 4 vite.
- Përcaktoni shpenzimet e zhvlerësimit vjetor, zhvlerësimin e akumuluar dhe vlerën kontabël të makinerive për të gjitha vitet e jetëgjatësisë përmes metodës së saldove zvogëluese.

Shitja e pasurisë së përdorur

- Largimi i pasurisë në përdorim, nëpërmjet shitjes në kesh, rezulton me tri situata si në vijim:
 1. Shitja e pasurisë mbi vlerën kontabël (pjesën e pazhvlerësuar)
 2. Shitja e pasurisë baras me vlerën kontabël
 3. Shitja e pasurisë nën vlerën kontabël
- Në qoftë së pasuria shitet mbi vlerën kontabël rezulton fitimi nga shitja, ndërsa kur pasuria shitet nën vlerën kontabël rezulton humbja nga shitja.
- Fitimi dhe humbja regjistrohen në transaksionin e shitjes së pasurisë dhe të njëjtat në fund të periudhës raportohen në pasqyren e të ardhurave.

Shembull

- Supozojmë se firma “Elkos” për makinëritë e blera më 01.01.2012 me kosto fillestare 64.000 €, jetëgjatësinë e vlerësuar 5 vite dhe vlerën riziduale të vlerësuar 4.000 €. Llogaritja e zhvlerësimit vjetor është bërë me metodën lineare. Tani supozojmë se me 31 dhjetor 2014 “Elkos” i ka shitur makinëritë e përdorura në kesh për:
 - a) 30.000
 - b) 28.000
 - c) 25.000

Pyetje



Suksese!